

**NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.**

Për: Z/Znj. _____ (Aksionar/Përfaqësues/e i/e Aksionarit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Hene datë 18 Tetor 2021 ora 12:00 në ambientet e "BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Dhenia e miratimit për pjesëmarrjen e Banka Credins sh.a. në cilësinë e ortakut të pakufizuar, në krijimin e Fondit të Investimit Alternativ, të organizuar në formën e shoqërisë komandite SIK "Green View Alternative Investment Fund", nëpërmjet kontributeve në natyrë. Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të kësaj shoqërie do të jete kontributet në natyrë që janë pasuritë që Banka Credins zotëron pranë Zonës së Poros, Vlore.
2. Dhënia e autorizimit për Drejtorin e Përgjithshëm z. Maltin Korkuti që të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për përpilimin dhe përcaktimin e kushteve në përmbajtjen e akteve të themelimit të shoqërisë, si me sipër cituar, nënshkrimin eventuale të tyre, përcaktimin e organeve drejtuese dhe çdo lloj tagri tjetër që kërkohet nga ligji për përfundimin e procedurave të regjistrimit dhe vënies në funksionim të kësaj shoqërie, si dhe dhënia e kompetencave të plota për të përfaqësuar Bankën Credins në Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve dhe për çdo vendimmarrje të shoqërisë komandite SIK "Green View Alternative Investment Fund",
3. Propozim për marrjen në pronësi të kolateraleve të debitorëve të Bankës Credins si rezultat i procesit përmbartimor.
4. Miratimi i veprimeve të organeve dhe/ose strukturave që kanë vepruar në emër dhe për llogari të Bankës Credins për marrjen në pronësi të kolateraleve të debitorëve të Bankës Credins si rezultat i procesit përmbartimor.
5. Autorizohet Drejtoria të ndjeke të gjitha hapat ligjore dhe të nënshkruajë çdo akt, kërkesë, aplikim, kontrate, etj., deri në kompletimin e procesit të marrjes në pronësi të pasurive të sipërpërmendura në pikën 3 dhe 4.
6. Propozim për shitjen e aseteve të fituara nga banka për shkak të ndjekjes së procedurave përmbartimore.
7. Autorizohet Drejtoria të ndjeke të gjitha hapat ligjore dhe të nënshkruajë çdo akt, kërkesë, aplikim, kontrate, etj., deri në kompletimin e procesit të shitjes së aseteve të sipërpërmendura në pikën 6, qoftë nga vete Banka ose duke autorizuar të treta (ie punonjës etj.)

8. Propozim për miratimin e riemërimit të anëtarit të Këshillit Drejtues të Bankës Credins sh.a Z. Elton Toro.

9. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionareve të Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive me rend dite si më poshtë:

- 1) Mbi miratimin e Shoqërisë "Credins Invest" sh.a., për administrimin e fondit të investimeve alternative për shoqërinë komandite SIK, "Green View Alternative Investment Fund", në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit 56/2020 dhe Aktet nënligjore të dala nën zbatim të tij.
- 2) Mbi miratimin e regjistrimit pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, të Shoqërisë Komandite si Fond i Investimeve Alternative "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, nëpërmjet "Credins Invest" sh.a.
- 3) Mbi miratimin e tekstit të kontratës së Administrimit të fondit të investimeve alternative "Green View Alternative Investment Fund", shoqëri komandite SIK me subjektin Shoqëria "Credins Invest" sh.a..
- 4) Mbi miratimin e emërimit nën cilësinë e Depozitarit të FIA "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, American Bank of Investments, si dhe tekstin e kontratës me depozitarin.
- 5) Mbi miratimin e emërimit nën cilësinë e Audituesit të Jashtëm të FIA "Green View Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK, Grant Thornton Albania, si dhe tekstin e kontratës me Audituesit të Jashtëm të FIA.
- 6) Mbi miratimin e dokumentit "Prospekt" të Fondit të Investimeve Alternative "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK.
- 7) Çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji.

10. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet dhe regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tirane më 27.09.2021

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»
- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
 - a) të ngrëjë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».
- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.
- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.
- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.
- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.
- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.